

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE**  
**SHËRBIMEVE MBËSHTETESE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE**

*Formulari nr. 3*

[Datë 28.02.2024]

**FTESE PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Bashkia Tiranë  
Adresa Sheshi “Skenderbej”, Tiranë  
Tel/Fax 0035542256799  
E-mail administrative.prokurime@tirana.al  
Adresa e Internetit [www.tirana.al](http://www.tirana.al)

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë – Berlin – Tiranë”**.

Data e zhvillimit do të jetë **28.02.2024 ora 18.00** në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

1. **“Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë – Berlin – Tiranë”**, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Berlinit do të bëhet në datën 04.03.2024 në orën 06.00, mbërritja në orën 08.30.
- Kthimi nga Berlini drejt Tiranës do të bëhet në datën 08.03.2024, në orën 09.05, mbërritja në orën 11.20.

Direkt, bagazhe të përfshira .

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) **Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.**

*\*Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me*

*kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: [administrative.prokurime@tirana.al](mailto:administrative.prokurime@tirana.al)) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.